

Vështrim mbi tregjet

- Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Tetor 2022

Zhvillime të tjera

- Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra - Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”
- AMF zhvillon konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”

Publikime Profesionale

- Global Risk Regulator
- IOSCO publikon raportin mbi sjelljen dhe edukimin e investitorëve në kohë trazirash
- Menaxhimi i Rrezikut në Institucionet Financiare - Volumi 15, Nr. 4

Informacione Ndërkombëtare

Bosnje-Hercegovina

Kosovë

Kroaci

Mali i Zi

Vendet e Evropës Qendrore dhe Lindore

Mbrojmë Konsumatorët - Promovojmë Tregjet - Zbatojmë Ligjin

Zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri, Janar–Tetor 2022

Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për periudhën janar-tetor 2022 kapën vlerën 17,183 milionë lekë, ose 9.16% më shumë se në janar-tetor 2021. Gjatë periudhës janar-tetor 2022, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,089,676 me një rritje prej 14.34% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.91% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, ndërsa sigurimet e Jetës kanë 8.02%. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 38.10% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 61.90% të totalit të tregut.


Gjatë periudhës janar-tetor 2022, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,324 milionë lekë, ose 4.77% më pak se në periudhën janar-tetor 2021.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin motorik për periudhën janar-tetor 2022 kapën vlerën 3,664 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 9.92% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-tetor 2022 arritën rreth 10,636 milionë lekë, ose 10.61% më shumë se në periudhën janar-tetor 2021.

Struktura e tregut të sigurimeve, Janar–Tetor 2022

(Në %)



ZHVILLIME TË TJERA

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete, në konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra - Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”



Përshëndetje të gjithëve,

Duke ju falenderuar për pjesëmarrjen, ju uroj mirëseardhjen në këtë konferencë, e dyta e këtij formati, që Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizon në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Sekretariatit Zviceran për Çështjet Ekonomike, të cilët i falenderoj për mbështetjen e vazhdueshme.

Le ta konsiderojmë këtë event, si një forum për dialog të përbashkët, me synim promovimin e rolit të sektorit financiar për një ekonomi të qëndrueshme dhe identifikimin e kushteve bazë për krijimin e një ekosistemi që nxit financa të gjelbra, sikurse mund të jetë një kuadër i përshtatshëm rregullator, një infrastrukturë e përshtatshme tregu, apo kërkesa për raportim dhe transparencë. Ky event synon rritjen e ndërgjegjësimit për efektet financiare dhe ekonomike të ndryshimeve klimatike dhe risqeve që lidhen me faktorët mjedisorë, socialë dhe të qeverisjes korporative, të ashtuquajturit faktorë ESG, si dhe shpresoj që të japë një impakt pozitiv në ndryshimin e sjelljes financiare të investitorëve shqiptarë për të konsideruar faktorët mjedisorë gjatë krijimit të portofolit të tyre të investimeve. Mobilizimi i flukseve financiare dhe i investimeve në projekte të gjelbra është me rëndësi për një të ardhme të qëndrueshme.

Një falenderim i veçantë edhe për të gjithë të ftuarit në panel, me rol kyç në këtë diskutim sa të domosdoshëm aq edhe sfidues, që do të ndajnë me ne eksperiencën lidhur me iniciativat e ndërmarra për financimin e gjelbër, një tematikë kjo që po merr vëmendje të shtuar dhe prioritet në nivel global, siç është edhe konferenca e Organizatës së Kombeve të Bashkuara për ndryshimet klimatike (COP27), që po zhvillohet gjatë këtyre ditëve.

Përmes angazhimit të ndërmarrë në marrëveshjen e Parisit, nënshkruar edhe nga Shqipëria në vitin 2016 apo axhendës 2030 të Kombeve të Bashkuara për një zhvillim të qëndrueshëm, të gjitha shtetet po ndërmarrin iniciativa për të financuar kalimin drejt një ekonomie të gjelbër dhe rrjedhimisht të qëndrueshme. Ndryshimet klimatike janë një problem global, një sfidë e përbashkët, me ndikim të drejtpërdrejtë në sistemin financiar.

vijon ...

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare "Financat e gjelbra - Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri"

... vijon

Komisioni Evropian, në dhjetor të vitit 2019 prezantoi iniciativën, e njohur si *European Green Deal*, një strategji që nxit investimet publike dhe private në projekte të qëndrueshme dhe që synon ta bëjë Europën kontinentin e parë neutral ndaj klimës dhe me emetim zero deri në vitin 2050. Sipas planit të investimeve të Bashkimit Evropian, parashikohet mobilizimi i rreth 1 trilion Eurove gjatë dekadës së ardhshme, ku gjithashtu 1/3 e fondit të parashikuar për rimëkëmbjen nga pandemia COVID-19 do të shërbejë për financimin e kësaj nisme. Diskutimet aktuale në BE mbi financat e qëndrueshme kanë shtuar detyra të reja për mbikëqyrësit e bankave, sigurimeve, fondeve të investimit, fondeve të pensionit, apo aktorëve të tjerë të sektorit financiar.

Në këto rrethana ka ardhur momenti që të ndërgjegjësohemi dhe të mendojmë se si mund t'i bëjmë faktorët mjedisorë që lidhen me qëndrueshmërinë, pjesë integrale të politikave tona financiare.

Dëshiroj të përgëzoj iniciativat e disa prej aktorëve të sektorit financiar shqiptar në përfshirjen e faktorëve mjedisorë në ushtrimin e veprimtarisë së tyre, por besoj se ka ende shumë për të bërë në këtë drejtim. Sektori financiar ka një rol kyç në arritjen e këtyre objektivave, pasi ai shërben për të riorientuar investimet drejt teknologjive dhe bizneseve të gjelbra, si edhe për të financuar rritjen në një mënyrë të qëndrueshme dhe afatgjatë. Riorientimi i kapitalit privat drejt investimeve të gjelbra kërkon një ndryshim të mendësisë në mënyrën se si funksionon sistemi financiar.

Por, suksesi i këtij objektiv varet shumë nga përfshirja dhe angazhimi i të gjithë aktorëve së bashku, sektorit publik, atij privat, ne si rregullatorë dhe mbikëqyrës dhe të gjithë palët e interesit.

Rritja e kërkesave për transparencë dhe informacion lidhur me faktorët ESG dhe menaxhimin e rrezikut të këtyre faktorëve përbën domosdoshmëri, në mënyrë që investitori të marrë vendime të mirëinformuara lidhur me produktet financiare. Bashkimi Evropian ka ndërmarrë ndryshime në kuadrin e vet rregullator për të përfshirë në legjislacion aspektet dhe faktorët që ndikojnë në qëndrueshmëri. Kështu së fundmi direktiva MIFID II, mbi bazën e së cilës është hartuar edhe ligji ynë mbi tregjet e kapitalit, ka pësuar ndryshime duke përfshirë elementët ESG. Këto ndryshime parashikojnë kërkesa të reja për bankat që ofrojnë shërbime investimi dhe për shoqëritë komisionere që gjatë vlerësimit të përshtatshmërisë së klientit për një produkt apo shërbim financiar të marrin në konsideratë edhe faktorët ESG, duke marrë informacion nga klienti edhe për preferencat e tij lidhur me këta faktorë. Shoqëritë komisionere duhet të kenë të gjitha mekanizmat e duhur që sigurojnë se produktet dhe shërbimet që ato synojnë të ofrojnë apo rekomandojnë janë në përputhje me nevojat e klientit, profilin e tij të rrezikut apo objektivat e tij, përfshirë edhe objektivat që lidhen me qëndrueshmërinë. Në kuadër të negociatave të Shqipërisë me BE-në dhe më specifikisht, të Kapitullit 9 "Shërbimet Financiare" që udhëhiqet nga Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, është marrë angazhimi për përputhje me direktivat europiane, përfshirë edhe amendimet e këtyre direktivave.

vijon ...

Fjala e Drejtorit të Përgjithshëm Ekzekutiv të AMF-së, Z. Ervin Mete në konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra - Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”

... vijon

Në nivel të Bashkimit Evropian, Rregulloret e taksonomisë, transparencës dhe benchmark-ut kanë krijuar kuadrin ligjor që nxit investime të qëndrueshme. Kështu rregullorja e taksonomisë krijon kushtet për një sistem të unifikuar klasifikimi, rregullorja e transparencës parashikon detyrimin e investitorëve institucionalë dhe menaxherëve të aseteve për të bërë publike informacionin mbi integrimin e faktorëve ESG në aktivitetin e tyre, përfshirë analizën e riskut të këtyre faktorëve. Ndërsa rregullorja e Benchmark vendos kërkesa, të cilat duhet të plotësohen nga ofruesit gjatë krijimit të një standardi klimatik, me qëllim sigurimin e integritetit dhe besueshmërisë, si një element i nevojshëm që i shërben krahasimit të performancës së portofolit të investitorit.

Si pjesë e planit të veprimit të saj për financa të qëndrueshme, aktualisht në qendër të diskutimeve të BE-së, është edhe krijimi i një standardi për obligacionet e gjelbra (*EU Green Bond Standard*). Një standard i unifikuar për obligacione të gjelbra, inkurajon pjesëmarrësit e tregut të emetojnë dhe investojnë në bonde të gjelbra dhe nxit efektivitetin dhe besueshmërinë në tregjet financiare.

Për gjithë sa më sipër, rregullatorët dhe mbikëqyrësit kanë rol thelbësor lidhur me krijimin e kushteve që nxisin investime të gjelbra, rritjen e kërkesave për transparencë dhe promovimin e nevojës për orientim të kapitalit drejt investimeve të qëndrueshme.

Shqipëria vlerësohet si vend me risk të lartë sa i përket katastrofave natyrore. Indeksi “Risk Inform” i Komisionit Evropian e vlerëson nivelin e përgjithshëm të rrezikut të Shqipërisë mbi mesataren e Bashkimit Evropian. Sektori financiar është direkt i ekspozuar ndaj këtyre rreziqeve. Por në anën tjetër, ky sektor mund të përshpjetojë kalimin drejt një ekonomie të gjelbër, duke u bërë financuesi kryesor i investimeve pro mjedisit, si edhe duke ofruar zgjidhje të transferimit të rrezikut.

Financat e gjelbra janë një tematikë e re për tregun tonë financiar dhe kjo bën edhe më shumë të nevojshme bashkëpunimin dhe koordinimin mes të gjithë aktorëve të përfshirë, si në drejtim të të kuptuarit, ashtu edhe sa i përket avancimit drejt financimeve të gjelbra dhe të qëndrueshme.

Uroj që diskutimet në këtë konferencë dhe në panelet e saj të shërbejnë në këtë drejtim.

Zhvillohet konferenca ndërkombëtare “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), organizoi më 16 nëntor 2022 konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”. Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të nivelit të lartë nga Qeveria shqiptare, institucionet financiare ndërkombëtare, rregullatorë dhe aktorë të tregjeve financiare.



Tiranë, 16 nëntor 2022 – Konferenca ndërkombëtare
“Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), organizoi më 16 nëntor 2022 konferencën ndërkombëtare “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”. Konferenca mbledhi së bashku përfaqësues të nivelit të lartë nga Qeveria shqiptare, institucionet financiare ndërkombëtare, rregullatorë dhe aktorë të tregjeve financiare.

Paneli i parë – “Këndvështrimi i institucioneve shqiptare”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në bashkëpunim me Bankën Botërore (BB) dhe Sekretariatit Shtetëror Zviceran për Çështje Ekonomike (SECO), organizoi më 16 nëntor 2022 konferencën ndërkombëtare me temë “Financat e gjelbra – Mundësi për sektorin financiar në Shqipëri”.

Konferenca ishte e organizuar në tre panele kryesore. Tema e panelit të parë ishte “Këndvështrimi i institucioneve shqiptare”. Panelistë në këtë diskutim të drejtuar nga z. Alper Ahmet Oguz, Specialist i lartë për sektorin financiar pranë Bankës Botërore, ishin z. Ervin Mete, Drejtor i Përgjithshëm Ekzekutiv i Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, znj. Mirela Kumbaro, Ministre e Turizmit dhe Mjedisit, znj. Frida Krifca, Ministre e Bujqësisë dhe Zhvillimit Rural dhe znj. Luljeta Minxhozi, Zv/Guvernatore e Parë e Bankës së Shqipërisë.

Panelistët diskutuan mbi perspektivat, mundësitë dhe rëndësinë e orientimit të financave të gjelbra drejt një zhvillimi ekonomik të qëndrueshëm, duke respektuar njëkohësisht ambjentin.





Paneli i dytë – “Këndvështrimi i aktorëve financiarë ndërkombëtarë”

Tema e panelit të dytë të konferencës ishte “Këndvështrimi i aktorëve financiarë ndërkombëtarë. Në panelin e drejtuar nga znj. Leah Ann Soroka, Menaxhere e Programit Evropian për Klimën dhe Financat në Korporatën Ndërkombëtare Financiare (IFC), z. Hubert Perr, Drejtues për Bashkëpunimin, Delegacioni i Bashkimit Evropian në Shqipëri, z. Justin Wray, Drejtues i Departamentit të Politikave në Autoritetin Evropian për Sigurimet dhe Pensionet Profesionale (EIOPA), znj. Milica Nikoliç, Specialiste për sektorin financiar pranë Bankës Botërore dhe znj. Ines Hobdari, Bankiere e Lartë për institucionet financiare pranë Bankës Evropiane të Investimeve (BEI). Panelistët ofruan pikëpamjet e institucioneve ndërkombëtare mbi rëndësinë e financimit të gjelbër.



Paneli i tretë – “Perspektiva e ndërmjetësve financiarë ndërkombëtarë”

Tema e panelit të tretë ishte “Perspektiva e ndërmjetësve financiarë ndërkombëtarë”. Në panelin e drejtuar nga z. Max Weber, Partner i Ernst & Young Gjermani, morën pjesë znj. Christa Geyer, Drejtuese e Qendrës për Kompetenca pranë Raiffeisen Capital Management, znj. Anna Stagnoli, Menaxhere për ESG dhe Aktivizimin Strategjik pranë Eurizon Capital Asset Management dhe z. Dieter Pscheidl, Drejtues i Çështjeve Evropiane dhe ESG pranë Vienna Insurance Group. Panelistët ndanë eksperiencat e tyre në lidhje me planet dhe politikat ESG (mjedisore, sociale dhe korporative), praktikat e ndjekura deri tani për financimet e gjelbra, si edhe sfidat për të ardhmen.

Rregullatorët kanë nisur përpjekjet për të ndaluar që shoku energjetik të kthehet në një krizë financiare

Global Risk Regulator

A SERVICE FROM THE BANKER

Fintech risks
Worries over potential model deterioration



Home

Subjects ▾

Regions ▾

Blog

Video

Subjects / Liquidity

Regulators move to stop energy shock becoming a financial crisis

Farah Khaliq | November 2, 2022



Financial regulators in Europe are buttressing banks to contain strains in the energy market and to stop them morphing into a full-blown financial crisis.

<https://www.globalriskregulator.com/Subjects/Liquidity/Regulators-move-to-stop-energy-shock-becoming-a-financial-crisis?ct=true>

Rregullatorët financiarë në Evropë po mbështesin bankat që të frenojnë tendosjet në tregun e energjisë dhe t'i ndalojnë ato të shndërrohen në një krizë financiare të plotë.

Publikohet raporti mbi sjelljen dhe edukimin e investitorëve në kohë trazirash



Në një raport të publikuar në nëntor 2022 IOSCO identifikon praktikën e mira edukuese të cilat duhet të merren në konsideratë nga rregullatorët e letrave me vlerë në situata krizash me synim mbështetjen e mbrojtjen e investitorëve.

Kuadri i rekomanduar për rregullatorët bazohet në mësimet e nxjerra nga pandemia COVID-19, e cila zbuloi se pandemia nuk pengoi përpjekjet për edukimin e investitorëve. Në fakt, shumë rregullatorë vazhduan, zgjeruan dhe/ose përshtatën aktivitetet e tyre të edukimit të investitorëve për të mbështetur mbrojtjen e investitorëve gjatë gjithë pandemisë. Shumë përpara COVID-19, rregullatorët kishin filluar të punonin për të mbrojtur investitorët që kishin njohuri të kufizuara për investime dhe përballëshin me një sërë zgjedhjesh komplekse investimi, duke adresuar gjithashtu edhe paragjykimet e sjelljes që mund të dëmtonin investitorët.

Megjithatë, raporti thekson se pandemia paraqiti sfida të reja dhe përkeqësoi disa çështje ekzistuese. Për shembull, periudha e COVID-19 shfaqti nivele të larta të paqëndrueshmërisë së tregut, një prirje rritëse në investimin e vetëdrejtuar, rritje të mbështetjes në mediat sociale për këshilla, si dhe një rritje e mashtrimeve në një kohë kur rritej pjesëmarrja e investitorëve të vegjël, (dhe të rinj dhe demografikisht të ndryshëm).

Megjithatë, masat me cilësi të lartë që synojnë mbrojtjen e investitorëve dhe rritjen e edukimit të investitorëve vazhdojnë të jenë një çështje kritike. Në të vërtetë, disa nga ndryshimet e vërejtura gjatë pandemisë pritet të zgjasin edhe përtej kësaj periudhe, siç është p.sh. lehtësia e pjesëmarrjes në tregun financiar e cila është sot me e lehtë se kurrë më parë, dhe investitorët me pakicë vazhdojnë të tregtojnë investime më të rrezikshme, ndërkohë që rregullatorët raportojnë një volum më të lartë të pretendimeve dhe ankesave të investitorëve.

Vijon ...

Materiali i plotë gjendet në:
<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS674.pdf>

Publikohet raporti mbi sjelljen dhe edukimin e investitorëve në kohë trazirash



Materiali i plotë gjendet në:

<https://www.iosco.org/news/pdf/IOSCONEWS674.pdf>

... vijon

2

Raporti propozon shtatë praktika të shëndosha që rregullatorët duhet të marrin parasysh kur hartojnë iniciativa financiare dhe edukimi për investitorët për të zbutur dhe trajtuar rreziqet dhe dobësitë e investitorëve me pakicë gjatë periudhave të krizës. Raporti ofron gjithashtu shembuj praktikë të iniciativave për edukimin financiar dhe mbrojtjen e investitorëve të zbatuara, nga juridiksione të ndryshme nga tregjet e zhvilluara dhe ato në zhvillim.

Pasquale Munafò, Kryetar i Komitetit të IOSCO-s për Investitorët me Pakicë, tha se “Pandemia COVID-19 na ka kujtuar se edukimi i investitorëve jep rezultate. Iniciativat për edukimin e investitorëve duhet të vazhdojnë të përshtaten me zhvillimet e tregut, duke ndryshuar nevojat dhe karakteristikat e investitorëve, dhe duke evoluuar rreziqet që sfidojnë mbrojtjen e investitorëve. Në një kontekst në të cilin pjesëmarrja me pakicë në tregjet e kapitalit është më e lehtë se më parë, edukimi i investitorëve duhet të eksplorojë dhe të gjejë mënyra të reja dhe të duhura për të arritur tek investitorët aktualë dhe të rinj dhe për t'i ndihmuar ata të zhvillojnë njohuri dhe sjellje të shëndosha në situata normale dhe krize”.


Volume 15 (2022)**SUBSCRIBE NOW >**

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

Volume 15 Number 4

- **Editorial: A cooperative equilibrium**
Julie Kerry, Publisher
- **Practice papers**
From modelling to forecasting bank profitability: Evidence from euro area banks
Marco Belloni, Risk Officer, Swiss Re, Mariusz Jarmuzek, International Monetary Fund and Dionysios Mylonas, European Central Bank




Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare” (*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)

Vëllimi 15, 2022, Numri 4 henrystewartpublications.com

Ky numër përmban ndër të tjera edhe artikujt e mëposhtëm:

- Editorial - “Një ekuilibër bashkëpunues” - Julie Kerry, botuese
- “Nga modelimi tek parashikimi i përfitimit të bankës: Dëshmi nga bankat e zonës euro” - Marco Belloni, Punonjës i analizës së rrezikut, Swiss Re; Mariusz Jarmuzek, Fondi Monetar Ndërkombëtar dhe Dionysios Mylonas, Banka Qendrore Evropiane
- “Zbatimi i CRR III: Ndikimi në kërkesat për kapital, performancën dhe modelet e biznesit të bankave evropiane” - Martin Neisen, Partner, PricewaterhouseCoopers dhe Hermann Schulte-Mattler, Profesor, Universiteti i Shkencave të Aplikuara dhe Arteve në Dortmund
- “Lidhja midis rrezikut të likuiditetit dhe rrezikut të kredisë: Dëshmi nga rajoni i Azisë Jugore” - Ajab Khan, Fakulteti i Biznesit, Ligjit dhe Teknologjive Dixhitale, Universiteti i Southampton Solent dhe Mustafa K. Yilmaz, Profesor, Shkolla e Biznesit, Universiteti Ibn Haldun
- “Analizimi i rrezikut të klimës në sektorin bankar: Deri në çfarë mase duhet të jetë barra e bankave për të financuar “marrëveshjen e gjelbër” duke u fokusuar në ndryshimin klimatik dhe profilin e rrezikut ESG? - Richard Bennett, CEO, Razor Risk
- “Mbikëqyrja dhe menaxhimi i rrezikut të skemave të pagesave” - Piet M. Mallekoote, Këshilltar dhe Mbikëqyrës i Pavarur dhe Suren K. Balraadjsing, Auditor i Skemës, Currency



Volume 15 (2022)


SUBSCRIBE NOW >

Each volume of *Journal of Risk Management in Financial Institutions* consists of four 100-page issues, published both in print and online.

The papers and case studies confirmed for Volume 15 are listed below:

Volume 15 Number 4

- **Editorial: A cooperative equilibrium**
Julie Kerry, Publisher
- **Practice papers**
From modelling to forecasting bank profitability: Evidence from euro area banks
Marco Belloni, Risk Officer, Swiss Re, Mariusz Jarmuzek, International Monetary Fund and Dionysios Mylonas, European Central Bank



Analizimi i rrezikut të klimës në sektorin bankar: Deri në çfarë mase duhet të jetë barra e bankave për të financuar “marrëveshjen e gjelbër” duke u fokusuar në ndryshimin klimatik dhe profilin e rrezikut ESG?

Richard Bennett, CEO, Razor Risk

Abstrakt

Temperatura e planetit Tokë është rritur mesatarisht me rreth 1.1 gradë Celsius që nga vitet 1880, konfirmuar nga matjet satelitore dhe nga analiza e qindra mijëra vëzhgimeve të pavarura të stacioneve të motit nga gjithë globi. Kjo shkallë e ngrohjes është rritur më shpejt se çdo gjetje tjetër në 65 milionë vitet e fundit në të dhënave paleoklimatike - rënia e shpejtë e mbulesës së akullit të sipërfaqes së planetit ofron dëshmi të mëtjeshme për këtë.

Industria bankare është kujdestari i financave globale. Prandaj, ajo ka një rol qendror për të luajtur në zbutjen e kësaj tendence. Në fund të fundit, këto janë institucionet që zënë një pozicion kyç si katalizatorë të rëndësishëm në riorientimin e flukseve financiare drejt aktiviteteve të qëndrueshme, duke mbështetur industrinë dhe qeverinë në përmbushjen e objektivave të tyre mjedisore, sociale dhe të qeverisjes (ESG). Megjithatë, a duhet të jetë përgjegjësia e sektorit bankar për të drejtuar këtë agjendë? Po, ka një rol të rëndësishëm për të luajtur, por a duhet të jetë industria bankare ajo që të shkruaj narrativen e përgjithshme globale? Ne do të shikojmë se çfarë po bëjnë bankat tani për të matur dhe për të vepruar sipas rrezikut të tyre klimatik dhe profilin ESG, dhe do të shohim se sa duhet të presim që ato të financojnë strategjinë e përgjithshme të 'marrëveshjes së gjelbër' ose 'të pastër' gjatë vitit 2022 dhe më tej.

Megjithatë, të mos harrojmë, sektori bankar për shekuj ka qenë i fokusuar tek paratë dhe jo tek çështjet ESG. Për ata që janë të rinj në këtë temë, ne do të përdorim gjithashtu këtë dokument për të ofruar disa këshilla dhe sugjerime hap pas hapi për atë që bankat duhet të bëjnë tani për t'u përgatitur për çështjet e ESG. Punimi hapet me teorinë, më pas kalon në praktikë, me një sërë rastesh studimore. Këto mbulojnë masat që klientët bankar të Razor Risk kanë prezantuar për të zbutur rrezikun e klimës, duke ofruar një pikë referimi kritike për sektorin në tërësi.

Revista “Menaxhimi i Riskut në Institucionet Financiare”
(*Journal of Risk Management in Financial Institutions*)
Vëllimi 15, (2022) Numri 4

<https://www.henrystewartpublications.com/jrm/v15>

BOSNJE-HERCEGOVINË

www.xprimm.com

Të dhënat e tregut të shtatorit 2022 të publikuara nga AZOBiH - Agjencia e Sigurimeve të Bosnje-Hercegovinës, tregojnë së tregu i sigurimeve në vend e mbylli nëntëmujorin e vitit 2022 me një vëllim të prime të shkruara bruto me vlerë 668.66 milionë BAM, ose rreth 341.88 milionë euro. Kjo shifër shënon rritje krahasuar me të njëjtën periudhë një viti më parë. Siguruesit Federatës së Bosnje-Hercegovinës, FBiH-së gjeneruan pothuajse 70% të primeve të shkruara bruto, ndërsa siguruesit e vendosur në Republikën Serbe të Bosnjës realizuan prime bruto me vlerë 201.45 milion BAM.

Sektori i sigurimeve të Jo-Jetës realizoi rreth 79.07% të vëllimit total të primeve të tregut, me vlerë 528.73 milionë BAM, ose rreth 7.39% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndërsa shoqëritë e sigurimit të Jetës kontribuan me pjesën e mbetur, me 139.93 milionë BAM, ose 11.12% më shumë se e njëjta periudhë në vitin e kaluar.

Përsa i përket pagesave të sigurimeve, totali i dëmeve të paguara në të gjithë nivelin e tregut arriti në 283.16 milionë BAM, ose rreth 144.78 milionë euro. Kjo shpreh një rritje me 16.72% në terma vjetorë. Dëmet e paguara si rrjedhojë e kontratave të sigurimit të Jetës përbënin 75.26 milionë BAM, ndërsa në dosjet e dëmeve të hapura për nënklasat e Jo-Jetës, siguruesit vendas raportuan pagesa me vlerë 207.90 milionë BAM.

KOSOVË

www.xprimm.com

Siç tregojnë shifrat mujore zyrtare të publikuara në faqen e Bankës Qendrore të Kosovës, BQK, vëllimi i primeve të shkruara bruto i siguruesve në vend gjatë periudhës janar-shtator 2022 arriti në 98.3 milionë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 11.3% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, totali i dëmeve bruto të paguara u rrit me 2.2%, duke arritur në 46.6 milionë euro.

Sipas publikimit nga BQK, primet e shkruara bruto nga sigurimet e Jo-Jetës arritën në 93.4 milionë euro, nga 84.8 milionë euro gjatë periudhës janar-shtator 2021, ndërsa primet e sigurimit të Jetës u rritën në 4.9 milionë euro nga 3.5 milionë euro.

Për të njëjtën periudhë kohore, asetet e zotëruara nga kompanitë e sigurimit kosovar janë rritur në 260.7 milionë euro më 30 shtator 2022, nga 235.7 milionë euro një vit më parë.

Të dhënat e publikuara më sipër përfshijnë informacione për 12 kompani të sigurimit që operojnë në Kosovë, 10 janë sigurues të Jo-Jetës dhe dy shoqëri sigurimi të Jetës.

KROACI

www.xprimm.com

Sipas shifrave mujore të publikuara *online* nga Byroja e Sigurimeve të Kroacisë (HUO - Croatian Insurance Bureau), vëllimi i primeve të shkruara bruto për 15 siguruesit me bazë në Kroaci, anëtarë të HUO, në fund të tremujorit të tretë të vitit arriti në 9.73 miliardë HRK, ose afërsisht rreth 1.29 miliardë euro. Kjo shifër shënon një rritje me 7.9% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Primet e shkruara bruto të Jo-Jetës në periudhën janar-shtator 2022 u rritën me 10.65% krahasuar me të njëjtën periudhë të vitit 2021 duke arritur në 7.55 miliardë HRK, ose rreth 1 miliardë euro, ndërsa primet e sigurimit të Jetës në të njëjtën periudhë ranë me 0.62%, duke arritur në 2.18 miliardë HRK, ose 290 milionë euro.

MALI I ZI

www.xprimm.com

Sipas të dhënave tremujore të tregut, të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, në fund të shtatorit 2022, tregu i sigurimeve në vend arriti vlerën e primeve të shkruara bruto prej rreth 82.79 milionë euro, ose 11.23% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Ndërkohë, për të njëjtën periudhë, vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit arriti në 33.11 milionë euro, me një rritje prej 7.45% krahasuar me këtë periudhë të vitit 2021.

VENDET E EVROPËS QENDRORE DHE LINDORE

www.xprimm.com

Në gjysmën e parë të vitit 2022, primet e shkruara bruto të vendeve të Europës Qendrore dhe Lindore (EQL) arritën në 22.17 miliardë euro në nivel rajoni, duke u rritur me rreth 7% në terma vjetorë. Në të njëjtën kohë, dëmet e paguara janë rritur me 11.5% në terma vjetorë, duke arritur në 12.64 miliardë euro.

Me përjashtim të Polonisë, të gjitha tregjet e EQL panë një dinamikë pozitive, në shumë raste me norma dyshifrore. Rumania është deri tani me performancën më mbresëlënëse në këtë drejtim, me një normë rritjeje vjetore të primeve të shkruara bruto prej 36%. Baltiku dhe Çekia kanë raportuar gjithashtu ritme të larta rritjeje.

Megjithatë, ritmet e larta të rritjes nuk janë një lajm aq i mirë sa mund të duket, pasi pjesa më e madhe e rritjes është inflacioniste e shoqëruar edhe me rritje të ngjashme të dëmeve të paguara. Jo rastësisht, të njëjtat vende që kanë parë ritmet më të larta të rritjes si në primeve si edhe të shpenzimet e dëmeve, janë gjithashtu vendet me inflacionin më të lartë. Rritja e normës së inflacionit çoi në rritjen e çmimeve të materialeve dhe shërbimeve, dhe rrjedhimisht pagesat më të larta të dëmeve bruto të paguara dhe shpenzimet operative bruto më të larta, si rezultat i të cilave siguruesit rishikuan çmimet e sigurimeve në shumicën e klasave të sigurimeve të Jo-Jetës, gjatë gjysmës së parë të vitit. Tendanca më e dukshme është në sigurimet motorike.

Polonia, Çekia, Hungaria, Rumania, Sllovenia janë 5 vendet me ecurinë më të mirë në terma të primeve të shkruara bruto, duke ruajtur hierarkinë në fund të vitit 2021. Megjithatë, ka dallime në pjesën e tregut rajonal, pasi Polonia humbi pothuajse 3 pikë përqindje të peshës së saj, kryesisht marrë nga Çekia (+1.5 pp) dhe Rumania (+1 pp).



AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Për informacion të mëtejshëm
ju lutemi na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686
amf@amf.gov.al | www.amf.gov.al